



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO  
**GJYKATA KUSHTETUESE**  
**УСТАВНИ СУД**  
**CONSTITUTIONAL COURT**

Prishtinë, më 8 korrik 2013  
Nr. ref.:RK441/13

## AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

**Rastin Nr. KI128/12**

Parashtrues

**Shaban Hoxha**

**Kërkesë për vlerësimin e kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, Rev. nr. 316/2011, të 14 qershorit 2012**

e përbërë nga:

Enver Hasani, Kryetar  
Ivan Čukalović, Zëvendëskryetar  
Robert Carolan, gjyqtar  
Altay Suroy, gjyqtar  
Almiro Rodrigues, gjyqtar  
Snezhana Botusharova, gjyqtare  
Kadri Kryeziu, gjyqtar, dhe  
Arta Rama-Hajrizi, gjyqtare

### Parashtruesi i kërkesës

1. Parashtrues i kërkesës është z. Shaban Hoxha (në tekstin e mëtejmë: parashtruesi i kërkesës), nga Prishtina, me banim në Prishtinë, rr. "Nazim Gafurri", nr. 13.

## **Vendimi i kontestuar**

2. Vendimi i kontestuar i autoritetit publik është Aktgjykimi i Gjykatës Supreme në Prishtinë, Rev. nr. 316/2011, i 14 qershorit 2012, për të cilin, në formularin për parashtrimin e kërkesës në Gjykatë, pala ka theksuar se e ka pranuar më 4 dhjetor 2012.

## **Objekti i çështjes**

3. Çështje bazë e lëndës së parashtruar në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata), më 6 dhjetor 2012, është vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme në Prishtinë, Rev. nr. 316/2011, të 14 qershorit 2012, me të cilin parashtruesit të kërkesës i është refuzuar revizioni i paraqitur kundër Aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut në Prishtinë, Ac. nr. 784/2009, i 11 marsit 2011.

## **Baza juridike**

4. Neni 113.7 i Kushtetutës; neni 22 i Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Nr. 03/L-121, të 15 janarit 2009; dhe rregulli 56 (2) i Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës.

## **Procedura në Gjykatën Kushtetuese**

5. Më 10 dhjetor 2012, parashtruesi e dorëzoi kërkesën e kompletuar në Gjykatë, dhe e njëjta u regjistrua në regjistrin përkatës të Gjykatës, me Nr. KI128/12.
6. Më 14 janar 2013, me Vendimin GJ. R. KI128/12, Kryetari i Gjykatës caktoi Gjyqtar raportues zëvendëskryetarin Ivan Čukalović, dhe të njëjtën ditë Kryetari caktoi edhe Kolegjin shqyrties, në përbërje: Almiro Rodrigues, kryesues, dhe Snezhana Botusharova e Kadri Kryeziu, anëtarë.
7. Më 25 mars 2013, Gjykata Kushtetuese njoftoi parashtruesin e kërkesës dhe Gjykatën Supreme për regjistrimin e kërkesës.
8. Më 17 qershor 2013, Kolegji shqyrties e shqyrtoi raportin e Gjyqtarit raportues dhe i paraqiti Gjykatës rekomandimin për papranueshmërinë e kërkesës.

## **Përbledhja e fakteve**

9. Më 23 tetor 2003, Korporata Energetike e Kosovës(në tekstin e mëtejmë: KEK) – Fondi pensional – nxori Vendimin nr. 171/29 përkitazi me aplikimin për pension, i cili i dedikohet aplikuesit z. Shaban Hoxha, në bazë të cilit z. Hoxha i aprovohet kërkesa për pension të parakohshëm në KEK dhe atë sipas kategorisë B dhe kjo në përputhje me Rregulloren e UNMIK-ut 2001/35 dhe me Statutin e fondit pensional të KEK-ut.

10. Në vendimin si më sipër përcaktohej se pagesa e pensionit për z. Hoxha do të fillojë nga data 1 nëntor 2003 dhe do të përfundojë më 1 dhjetor 2008, ndërsa lartësia e pensionit do të jetë 105.00 € në muaj. Në vendim, gjithashtu, theksohej se pala e pakënaqur me vendimin mund të ushtrojë ankesë në afat prej 15 ditësh dhe ajo i drejtohet Komitetit për rishqyrtimin e mospajtimeve, nëpërmjet administratës së fondit pensional të KEK-ut
11. Nga dokumentacioni i dorëzuar nga parashtruesi i kërkesës së bashku me kërkesën, Gjkata gjen se kundër vendimit të fondit pensional të KEK-ut nuk është ushtruar ndonjë ankesë.
12. Pas datës 1 dhjetor 2008, KEK-u ka ndërprerë pagesën e pensionit për z. Shaban Hoxha dhe ky fakt konstatohet nga Aktgjykimi i Gjykatës Komunale, CI. nr. 437/2008.
13. Më 26 mars 2009, Gjkata Komunale në Prishtinë nxori Aktgjykimin CI. nr. 437/2008, me të cilin refuzoi kërkesëpadinë e paditësit, z. Shaban Hoxha nga Prishtina, me të cilën ai kishte kërkuar nga Gjkata “që të obligojë të paditurin, KEK-un, që t’ia paguajë pensionin sipas Vendimit nr. 171/129, të 23 tetorit 2003, duke filluar nga 1 dhjetori 2008 e derisa të ekzistojnë kushtet për pagesën e tij”.
14. Në arsyetimin e këtij aktgjykimi, Gjkata Komunale konstatoi ndër të tjera: “*Midis palëve nuk ka qenë kontestues fakti se paditësi e ka realizuar pensionin suplementar për 60 muaj në shumë mujore prej 105 eurosh, e nuk ka qenë kontestues as fakti se pas 60 muajsh, paditësit i është ndërprerë kjo pagesë, përkatësisht përfundon më 1 dhjetorit 2008*”. Gjkata, gjithashtu, konstatoi se “*është vërtetuar fakti se i padituri i ka përbushur në tërsi detyrimet ndaj paditësit, të parapara me vendimin për pensionimin e paditësit*” dhe se “*kërkesëpadia e paditësit për vazhdimin e pagesës së pensionit edhe pas 1 dhjetorit 2008 rezulton e pabazuar, prandaj edhe vendosi që të njëjtën ta refuzojë si të tillë*”.
15. Më 11 mars 2011, Gjkata e Qarkut në Prishtinë nxori Aktgjykimin Ac. Nr. 784/2009, me të cilin refuzoi si të pabazuar ankesën e z. Shaban Hoxha, me arsyetimin se, “*sipas konstatimit të kësaj gjykate, i drejtë është konkludimi i gjykatës së shkallës së parë se kërkesëpadia e paditësit është e pabazuar. Aktgjykimi i shkallës së parë është bazuar në vërtetimin e drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike në të cilën ka pasuar edhe aplikimi i drejtë në të drejtën materiale*”.
16. Më 14 qershor 2012, Gjkata Supreme e Kosovës, duke vendosur sipas kërkesës së parashtruesit, nxori Aktgjykimin Rev. 316/2011, me të cilin e refuzoi si të pabazuar revizionin e paraqitur nga parashtruesi kundër Aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut në Prishtinë.
17. Në arsyetimin e aktgjykimit, Gjkata Supreme theksoi: “*Gjkata Supreme e Kosovës, duke u nisur nga gjendja e tillë e çështjes, ka gjetur se gjykatat e instancës më të ulët drejt e kanë zbatuar të drejtën materiale, kur kanë gjetur se kërkesëpadia e paditësit është e pabazuar*”.

18. Më 10 dhjetor 2012, përfundimisht i pakënaqur me vendimet gjyqësore, z. Hoxha parashtroi kërkesë në Gjykatën Kushtetuese.

### **Pretendimet e parashtruesit për shkeljet kushtetuese**

19. Parashtruesi i kërkesës pretendon se, me aktgjykimin e kontestuar, atij i janë shkelur të drejtat e garantuara me Kushtetutën e Republikës së Kosovës, si në vijim: neni 49 (E Drejta për Punë dhe Zgjedhje të Profesionit), neni 24 (Barazia Para Ligjit) dhe neni 6 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (E Drejta në Gjykim të Drejtë e të Paanshëm).
20. Parashtruesi i kërkesës gjithashtu pohon se Gjykata Supreme, duke nxjerrë revizionin sipas kërkesës së tij, e ka vënë në pozitë të pabarabartë para ligjit, sepse në një rast identik me të tijin ka nxjerrë Aktgjykimin Rev. nr. 152/2009 të, 12 prillit 2010, ku kjo gjykatë ka aprovuar revizionin e atij parashtruesi, ndërsa revizionin e parashtruar nga ai e ka refuzuar.

### **Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës**

21. Për të qenë në gjendje të gjykojë mbi kërkesën e parashtruesit, Gjykata paraprakisht vlerëson nëse parashtruesi i ka përbushur kriteret e pranueshmërisë, të parapara me Kushtetutë, me Ligjin për Gjykatën Kushtetuese dhe me Rregulloren e punës së Gjykatës.
22. Për këtë, Gjykata i referohet nenit 113.1 të Kushtetutës (Juridiksi i Palët e Autorizuara) që përcakton:

*“Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para Gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar”.*

23. Gjykata gjithashtu merr parasysh rregullin 36 të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese, ku përcaktohet:

*“(1) Gjykata mund t’i shqyrtojë kërkesat vetëm nëse:*

*c) Kërkesa është qartas e bazuar”...*

24. Duke iu referuar kërkesës së parashtruesit dhe shkeljeve të pretenduara të të drejtave kushtetuese, Gjykata Kushtetuese konstaton se parashtruesi i ka shteruar të gjitha mjetet juridike të parapara me ligj dhe që i kishte në dispozicion si dhe kërkesën e ka parashtruar në afatin ligjor të paraparë me nenin 49 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese, andaj, në këto rrethana, Gjykata do të shqyrtojë bazueshmërinë e shkeljeve të pretenduara kushtetuese, ashtu sikur i ka paraqitur parashtruesi në kërkesë.
25. Në këtë drejtim, Gjykata thekson se Gjykata Kushtetuese nuk është gjykatë e faktit dhe, me këtë rast, dëshiron të theksojë se konstatimi i gjendjes së drejtë dhe të plotë faktike është juridiksi i plotë i gjykatave të rregullta si, në rastin konkret, i Gjykatës Supreme, duke refuzuar revizionin e paditësit apo të Gjykatës së Qarkut, duke refuzuar ankesën e ankuesit, dhe se roli i saj (i Gjykatës Kushtetuese) është vetëm që ta sigurojë pajtueshmërinë me të drejtat

që garantohen me Kushtetutë dhe me instrumente të tjera ligjore dhe prandaj nuk mund të veprojë si gjykatë e shkallës së katërt” (Shih, *mutatis mutandis*, i.a., Akdivar kundër Turqisë, 16 shtator 1996, R.J.D, 1996-IV, para. 65).

26. Fakti i thjeshtë se parashtruesit janë të pakënaqur me rezultatin e rastit, nuk mund t'u shërbejë atyre si e drejtë të ngrenë një kërkesë të argumentueshme për shkelje të nenit 31 të Kushtetutës, apo nenit 6 të KEDNJ-së (Shih, *mutatis mutandis*, aktgjyki i ECHR, Kërkesa Nr. 5503/02, Mezotur-Tiszazugi Tarsulat kundër Hungarisë, aktgjyki i 26 korrikut 2005, ose Tengerakis v. Qipro, nr. 35698/03, vendim i 9 nëntorit 2006, § 74).
27. Parashtruesi i kërkesës nuk kishte paraqitur asnjë argument valid që do t'i mbështete pohimet e tij për shkelje të nenit 49 të Kushtetutës dhe përpos pohimit se ai kishte një vendim të ligjshëm për pension dhe kërkesës se ai pension do të duhej të vazhdonte t'i paguhej, nuk kishte arsyetuar se si i është shkelur e drejta e garantuar me Kushtetutë. Për më tepër, gjykatat e rregullta, në procedura të rregullta dhe ligjore, kishin konstatuar se ishin përm bushur në tërësi obligimet që dalin nga vendimi i të paditurit, KEK-ut, dhe në favor të paditësit z. Hoxha. Në fakt, parashtruesi i kërkesës as që i kishte kontestuar procedurat dhe procesin në tërësi, por rezultatin përfundimtar të proceseve gjyqësore, e që nuk ishte i favorshëm për të.
28. Për më tepër, për t'u deklaruar një aktgjykim apo një aktvendim i një autoriteti publik si jokushtetues, parashtruesi i kërkesës do të duhej të dëshmonte *prima facie* para Gjykatës Kushtetuese se “vendimi i autoritetit publik, si i tillë, do të jetë tregues i një shkeljeje të kërkesës për gjykim të drejtë, dhe nëse paarsyeshmëria e atij vendimi është aq e dukshme sa që vendimi mund të konsiderohet si vendim tej mase arbitrar (Shih, GJEDNJ, *Khamidov kundër Rusisë*, nr. 72118/01, aktgjyki i 15 nëntorit 2007, § 175).
29. Gjykata Kushtetuese, në Aktgjykin e Gjykatës Supreme Rev. 316/2011, e 14 qershorit 2012, nuk gjeti elemente të arbitraritetit dhe as shkelje të supozuar të të drejtave të njeriut, sikur që kishte pretenduar parashtruesi i kërkesës.
30. Sa i përket pretendimit për shkelje të së drejtës së garantuar me nenin 24 të Kushtetutës (Barazia Para Ligjit), për të cilën parashtruesi pohon se i është shkelur duke e argumentuar këtë me faktin se Gjykata Supreme në një rast identik ka nxjerrë aktgjykim të ndryshëm, Gjykata konstaton se, në rastin e përmendor nga parashtruesi, procesi i zhvilluar gjyqësor ishte thellësisht i ndryshëm.
31. Në të vërtetë, në rastin e parashtruesit Z. B. (për të cilin pretendohet se është identik), gjithashtu një pensionist i KEK-ut, Gjykata Komunale dhe ajo e Qarkut kishin vendosur në favor të parashtruesit Z. B., ndërsa pas revizionit të ushtruar nga KEK-u, Gjykata Supreme Rev. nr. 152/2009, të 12 prillit 2010, e kishte aprovar si të bazuar revizionin e KEK-ut, pra të palës së paditur, e jo të paditësit dhe, në këto rrethana, Gjykata nuk mund të konstatojë se ka pasur shkelje të nenit 24 të Kushtetutës.
32. Gjykata gjithashtu thekson se parashtruesi i kërkesës nuk kishte paraqitur në cilësi të provës një akt marrëveshjeje individuale të lidhur ndërmjet tij dhe

KEK-ut, sikur që kishin parashtruesit e kërkesave të paraqitura nga grupe punëtorësh të KEK-ut, gjithashtu ish-pensionistë të kësaj kompanie, në të cilat theksohej se pensioni do t'u paguhej “*deri në themelinin dhe funksionimin e Fondit mbi Sigurimin Pensional dhe Invalidor të Kosovës*” (Shih, aktgjykimet e Gjykatës Kushtetuese të 23 qershorit 2010, të parashtruesit z. Imer Ibrahim i dhe 48 të tjerë, dhe të 23 qershorit 2010, të parashtruesit z. Gani Prokshi dhe 15 të tjerë), por kishte një vendim për pension për kohë saktësisht të caktuar, të cilin e kishte pranuar dhe nuk e kishte kundërshtuar, andaj Gjykata nuk gjeti argumente që këtë kërkesë ta trajtojë sikur rastet e kësaj gjykate, të përmendura më sipër, të parashtruara nga grupe ish-punonjësish të KEK-ut.

33. Në këto rrethana, parashtruesi i ankesës nuk ka “argumentuar në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij”. Nuk ka paraqitur një kërkesë në mënyrë ligjore dhe nuk mund të konstatohet se kërkesa ishte e bazuar, andaj Gjykata, në përputhje me rregullin 36, paragrafi 2, pika c dhe d, gjen se kërkesën duhet ta refuzojë si qartazi të pabazuar dhe rrjedhimisht


## PËR KËTO ARSYE

Në mbështetje të nenit 113.7 të Kushtetutës; në mbështetje të nenit 20 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese dhe në mbështetje të rregullit 56.2 të Rregullores së punës, Gjykata Kushtetuese, më 8 korrik 2013, njëzëri

## VENDOSI

- I. TA HEDHË POSHTË kërkesën si të papranueshme;
- II. Ky vendim do t'u komunikohet palëve dhe do të publikohet në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese;
- III. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari rapportues



Prof. dr. Ivan Čukalović

Kryetari i Gjykatës Kushtetuese



Prof. dr. Enver Hasani

